



VENDIM

Nr. 71 Datë 13.05.2015

**PËR LICENSIM E SHOQERISE “KOXHERRI ENERGJI” SH.P.K., NE
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 2; 13 dhe 14 pika 1 të “*Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave*”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.05.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**KOXHERRI ENERGJI**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave*” si më poshtë:

Neni 9, pika 1 është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2 është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 3 është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4./10 gërma a është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10 gërma b është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4/10 gërma c është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërise “KOXHERRI ENERGJI” sh.p.k., në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike për një afat 30 vjecar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI